



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË  
GJIMNAZI "MYSLYM SHIMA" YZBERISHT

Nr. 150/1 prot

Tirane ,me 25.06.2015

**LËNDA: NJOFTIM PËR VËND TË LIRË PUNE**

Drejtorja e shkollës së mesme "Myslim Shima" Yzberisht në zbatim të Nenit 60 të Ligjit Nr.69/2012 ,date 21.06.2012 " Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë " , si dhe të udhëzimit nr.56 , date 12.11.2013 "Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit nga puna të mësuesit të institucionit arsimor publik të arsimit parauniversitar " nga MAS ,shpall konkursin për vend të lire pune në pozicionin **mësues matematike** ,në Shkollën e Mesme "Myslim Shima" Yzberisht .

**KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT**

Kandidati /ja për mësues në institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet :

- a) Te ketë diplomë në fushen e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të sipas përcaktimeve te Ligjit nr.10171, datë 22 .10.2009 " Për profesionet e rregulluara ne Republikën e Shqipërisë " ,të ndryshuar dhe aktet nënligjire të nxjerra në zbatim të tijë (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë )

**DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidati /ja për mësues matematike në institucionin publik të arsimit parauniversitar duhet :

- a)CV- në dhe kopje të dokumentave që vërtetojnë pohimet në CV(sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.1 , bashkëlidhur këtij udhëzimi .)
- b) Tabela e të dhënave për aplikant ( sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.2 , bashkëlidhur këtij udhëzimi .)
- c) Raport mjeko-ligjor .
- d)Dëshminë e masave disiplinore në fuqi në ngarkim të tijë( në se nuk ka , e deklaron me shkrim që nuk ka )

e) Dëshminë e penaltetit të lëshuar jo me herët se tri muaj para datës së aplikimit.

f) Dy rekomandime nga mësues ose drejtorë të institucioneve arsimore ose titullarë të njësive arsimore vendore që kanë punuar me aplikantin gjatë vitëve të fundit (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.3 , bashkëlidhur këtij udhëzimi .)

Dokumentacioni i aplikimit ,dorëzohet në drejtorinë e institucionit arsimor publik .

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së kërkesës për mësues nga institucioni publik i arsimit parauniversitar .

Konkurimi do të zhvillohet në ambjentet e shkollës së mesme “Myslim Shima”  
,Yzberisht ,Tiranë në datën , 06,07,2015

DREJTORI

Mira HOXHA

P. 2V. DREJTORI

Zelije SINA



*Zelije Sina*  
2015